



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SH.A

Nr. _____ prot.

Elbasan, më: ____ .08. 2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHERBIM MIREMBAJTJE AUTOMJETESH DHE
MJETE PUNE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Riparime mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjetet, 50100000-6 , pjesë këmbimi për automjete 34330000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 9955183 (nente milion e nenteqind e nentedhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre leke)**Monedha, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan*, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;
ukrajonielbasan@gmail.com

2.1.1 Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin Licencë të vlefshme, kategoria VII.3.B “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për vendin ku ushtron aktivitetin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të shoqëruar me Akt-ekspertizën e Ekspertit Kontabël të autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2003 “Për auditim ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit dhe të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të jenë shënuar vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës në përbërje të të cilit të ketë jo më pak se 4 (kater) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës teknik;
- b) 1 (një) motorist;
- c) 1 (një) mekanik;
- d) 1 (një) elektroauto;

Në lidhje me punonjësin në pikën (a), OE duhet të paraqesë:

- Dëshmia e aftësisë profesionale;
- Kontratë pune të vlefshme si Përgjegjës teknik.

Për secilin prej punonjësve në pikat b,c,d më sipër duhet të paraqitet:

Adresa: Lagjja: "Brigada XVII Sulmuese", Rruga: "PetraqPopa", Elbasan, Albania;
ukrajonielbasan@gmail.com

- Kontratë Pune të vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorrist, mekanik, elektroauto;
- Ku dy prej punëtorëve të jenë të pajisur me diplomën e arsimit të mesëm profesional.
- Ku një prej punëtorëve të ketë dëshmi patente për drejtim kamioni;
- Të jenë të regjistruar në Listë-pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore **për një periudhë jo më të vogël se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.**

Nr.	Personeli	Emër mbiemër	Data e lidhjes së kontratës	Afati i përfundimit të kontratës
1.				
2.				
3.				

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41 pika 4/b dhe 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin/personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Konkretisht referuar natyrës së shërbimeve që kërkohet të kryhen siç janë riparimi dhe mirëmbajtja e agregatit të motorit, karrocërisë, të sistemeve të drejtimit dhe të frenimit, kondicionimit amortizimit etj., është e nevojshme pasja e një stafi teknik me profesione si motorist, xhenerik, elektroauto, e vërtetuar kjo në bazë të kontratave të punës, si dhe me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, AK ka kërkuar që OE të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalist për realizimin e objektit të kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve **brenda territorit të Bashkisë Elbasan**

Për këtë, OE duhet të paraqesë:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose qira ose nënqira ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjedisi, mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate, është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;
ukrajonielbasan@gmail.com

cilat duhet të dërgohen në mjediset e servisit, është e domosdoshme që OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht një mjedis për ushtrimin e veprimtarisë, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, dhe ky mjedis duhet të jetë në një vend/largësi të arsyeshme nga vend-qëndrimi i mjeteve të shoqërisë **me qëllim minimizimin e kostos kohore dhe ekonomike të transportit.**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) Pajisje (ura) ngritëse për servis, të instaluar në objektin e servisit, nga të cilat 3 (tre) për mjetet objekt prokurimi, ku njëra të jetë e tipit gërrshërë 5 ton;
- b) Pajisje për pastrimin e marmidave katalitike DPF
- c) Pajisje për kontrollin, riparimin dhe kalibrimin e turbinave të motorrit;
- d) Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- e) Pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- f) Pajisje për cmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës së mjetit;
- g) Pajisje për kontrollin, balancimin e disqeve dhe gomave të mjetit.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- a) Për pajisjet ngritëse të paraqitet raport inspektimi konformiteti;
- b) Dokumente që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qira ose huapërdorje (fatura blerjeje/ dokumente zhdoganimit/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorjeje/ kontrata dhurimi/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit ose nëse kërkohet sqarim nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion, apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të riparojnë më shumë se dy mjete në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh edhe punën ditore të OE, urat ngritëse janë parashikuar për vijimësinë normale të punës si nga sasia ashtu edhe nga kapaciteti mbajtës.

- Pajisje (ura) ngritëse për servis, të instaluar në objektin e servisit, nga të cilat 3 (tre) për mjetet objekt prokurimi, ku njëra të jetë e tipit gërrshërë 5 ton; është e nevojshme për realizimin e shërbimeve në mënyrë efektive për të gjitha mjetet. AK disponon dhe automjete të tonazhit të rëndë dhe për këtë arsye kërkohet që ura të ketë kapacitet ngritës si më sipër.
- Pajisje për pastrimin e marmidave katalitike DPF është e nevojshme për pastrimin e shkarkimit të gazrave për të minimizuar emetimin e gazrave në ambient.
- Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; nevojitet për diagnostikimin e problemeve që paraqesin automjetet në sistemin e kondicionimit si dhe riparimin e tyre.
- Pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit; shërben për të siguruar riparim, shërbim dhe funksionim sa më cilësor të këtij sistemi të rëndësishëm.

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;
ukrajoni@elbasan@gmail.com

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojë minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet:

Dokumentacion për mjetin në pronësi ose me qira ose në huapërdorje (fatura blerjeje/ dokumente zhdoganimi/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorjeje/ kontrata dhurimi/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, dotë paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohet sqarim nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion, apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të defektuar në pamundësi vetë-lëvizje për në mjediset e servisit që OE disponon, është e domosdoshme që OE të kenë minimalisht një karrotrec.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se agregatat/ paisjet/ pjesët e këmbimit që do të ofrohen do të jenë të reja dhe sipas afateve të garancisë (jo me pak se 1 vit) të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate, synohet që mallrat (pjesët e këmbimit) që do të vendosen, të jenë të reja, origjinale ose ekuivalente, dhe minimumi të kenë 1 (një) vit garanci, dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për Autoritetin Kontraktor, riparimin mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë lind nevoja, në një defekt të përsëritur.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra sipas tabelës së mëposhtme para komisionit ditën e hapjes së procedurës.

1. Filter vaji automjete: Gazelle;
2. Filter naftë automjete: Gazelle;
3. Rrula zinxhire per esksvstor katerpillar.

Mos dorezimi i mostrave përbën kusht për skualifikim oferte.

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;
ukrajonielbasan@gmail.com

rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar bazuar në Udhëzimin Nr. 2 datë 02.05.2019. Faza e paraqitjes së mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ana jonë. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në piken 6 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument provues / kontratë/marreveshje të vlefshme me subjektin e autorizuar shoqëruar me dokumentacionin që e provon autorizimin/lejen perkatese për dorëzimin e vajrave të përdorura të subjektit që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve në përmbushje të VKM 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”.

Duke qenë se objekti i kësaj procedure prokurimi konsiston në kryerjen e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë realizimit të këtyre shërbimeve mund të gjenerohen vajra të përdorura dhe mbetje të tjera vajore, si rezultat i ndërrimit të vajrave dhe lubrifikantëve të automjeteve.

Për këtë arsye, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues për dorëzimin e vajrave të përdorura të një subjekti i pajisur me lejet/autorizimet perkatese për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e tyre vendoset me qëllim garantimin e grumbullimit, administrimit dhe trajtimit të këtyre mbetjeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik, gjatë ekzekutimit të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve,

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;

ukrajonielbasan@gmail.com

të sigurojë menaxhimin e rregullt dhe të ligjshëm të vajrave të përdorura të gjeneruara nga aktiviteti.

NJËSIA E PROKURIMIT

Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “PetraqPopa”, Elbasan, Albania;
ukrajonielbasan@gmail.com